

# Kronikë nga seanca nr. 36-të e KRD-ës

**Shkup, 19.07.2013**– Këshilli i Radiodifuzionit (KRD) në seancën e sotme e miratoi informacionin në lidhje me Kërkesën e SHTR 24 Vesti Shtip me çka kërkoi ndërmjetësim, logjistikë dhe përmbajtje nga Këshilli i Radiodifuzionit për transmetimin e servisit programor nga ana e operatorëve të rrjetit të komunikacionit publik. Këshilli konkludoi që tu drejtohet në mënyrë të shkruar operatorëve të rrjetit të komunikacionit publik Digi Plus Multimedija dhe Media end Broadband Blizu përt'urekomanduar, por derisa nuk veprojnë teknikisht , financiarisht ose pengesa të tjera, të njëjtat ta rriemetojnë servisin programor SHTR 24 Vesti – Shtip, në interes të pasurimit të të paketës programore me programe televizive vendore për shkak të kënaqësisë të audiencës televizive vendore. Nëse do të marre përgjigje negative, Këshilli do të organizoje Këshilli do të organizoje takim me palët e interesuara për tu kapërcyer pengesat në lidhje me transmetuesin e lartë përmendur.

KRD e miratoi informacionin në lidhje me Kërkesën e SHTR TV Era – Shkup e cila kërkoi intervenim nga Këshilli i Radiodifuzionit, me të cilën do të siguroje rriemetim të servisit programor të sajë nga ana e gjithë operatorëve kabllor të cilët veprojnë në zonën e rajonit të Shkupit. Këshilli konkludoi që të veproje në mënyrën e njejtë si dhe në rastin me SHTR 24 Vesti Shtip, me çka do tu drejtohet operatorëve kabllor nga rajoni i Shkupit (me përjashtim të operatorit kabllor i cili e rriemeton programin e TV Erës).

KRD e miratoi informacionin në lidhje me pagesën e kompensimit të lejes për kryerjen e veprimtarisë radiodifuzive të SHTR Energy Radio Strugë pas inicimit të procedurës për marrjen e lejes. Në pikëpamje të asaj që kompensimi i lejes edhe pas paralajmërimit të fundit nuk është i paguar në afatin e

paraparë, Këshilli konkludoi që t ia marrë e lejen për ushtrim të veprimtarisë radiodifuzive shoqërisë tregtare radiodifuzive Energy Radio – Strugë. Vendimi për marrje do të hyje në fuqi përdërisa SHTR Energy Radio – Strugë nuk i paguan mjetet, deri më datë 23 qershor 2013.

KRD e miratoi informacionin në lidhje me të drejtat ekskluzive dhe rriemetimin e ndeshjeve nga kampionati botëror në Formula 1 në territorin e Republikës së Maqedonisë dhe konkludoi që të hiqet mënyra për errësimin kanaleve të Sport Klubit nëritransmetimintyre në rrjetet e komunikacionit publik në Maqedoni gjatë kohës së mbajtjes së garave në Formula 1.

KRD e miratoi informacionin në lidhje me vizitën zyrtare tek SHTR DI-XHEJ SLAVE – Strugë dhe konkludoi se transmetuesi transmeton radio program në frekuencën e shpërndarë 102,2 MHz, në pritje me kualitet cilësor. Këshilli konkludoi për ndërprerjen e procedurës për marrjen e lejes për ushtrim të veprimtarisë radiodifuzive. Këshilli edhe më tej do ta ndjeke punën e SHTR DI-XHEJ SLAVE, veçanërisht në pjesën e plotësimit të kushteve për lejen.

Këshilli i Radiodifuzionit konkludoi që ti lëshojë vërtetimet e më poshtme për regjistrimin e pakove programore:

-DIGI PLUS MULTIMEDIA nr. 70/5 1000 Shkup, vërtetim nr. 11 me çka paketa e regjistruar programore si e tërë plotësohet me servisin programor televiziv Klasik TV.

-SHTR- operator i rrjetit të komunikacionit publik GIV Dostivarë nr. 217, vërtetim nr. 5 me çka paketa e regjistruar programore si e tërë plotësohet me serviset programore televizive: TV 2- Gostivar (lokale), TV Zëri i Çegranit – Gostivar (regionale), GTV – Gostivar (lokale), Kanal 5, Telma, Sport, klub, Sport klub plus, Sport klub prime, Golf klub, Fishing&Hunting, Ultra, Mini ultra, IQS live, Cinemania, Tring super, Tring sport, Tring world, Tring comedy, Tring shqip, Tring tring, Tring max, Tring life, Tring planet, X

tring Folk plus, Mediasat (SCAN), NTV, Vizion plus, Kanali 7, 3 plus, Club TV, TRV 21, RTV 21 populore, Planeta, Balkanika, Folklor TV, FEN TV, Animal Planet, Discovery channel, TLC, FOX, FOX life, FOX Crime, Nat.Geo.Channel, Nat.Geo.Wild, 24 Kitchen, Boomerang, Cartoon Network, TCM, Viasat Nature, Viasat History, Viasat Explorer, TV 1000, Chase&Peshe, ATV, Kanal D, STV, Star, OBN, Orlando Kids, Alternativna TV, NDR, 3 Sat, Kika, Arte, M 2, Kabel 1, HSE24, Sat 1, HRT 1, HRT 3, JRTS, N-TV, VOX и TV 5 Monde.

-SHTR – operator i rrjetit të kominikacionit publik INFEL KTV Ohër, vërtetim nr. 9 5 me çka paketa e regjistruar programore si e tërë plotësohet me serviset programore televizive: OBN dhe Orlando Klinci.

-Telekomit Maqedonas SHA Shkup, vërtetim nr. 44 me çka paketa e regjistruar programore si e tërë plotësohet me serviset programore televizive:TV Menada – Tetovë (locale) dhe Auto moto und Sport Chanel HD.

-Shoqërisë për inxhiniering telekomunikimi, softuer, tregti dhe shërbime BLIZU MEDIA END BROUDBEND Shkup, për qytetetet Shkup, Tetovë, Shtip, Prilep, vërtetim nr. 45 me çka paketa e regjistruar programore si e tërë plotësohet me serviset programore televizive:AGON Channel, Sky News, Nat Geo Wild dhe Baby TV.

-Shoqërisë për inxhiniering telekomunikimi, softuer, tregti dhe shërbime BLIZU MEDIA END BROUDBEND Shkup, për qytetin e Prilepit, vërtetim nr. 20 me çka paketa e regjistruar programore si e tërë plotësohet me servisin programor televiziv TV Lazhani – Prilep (lokale).

-Shoqërisë për inxhiniering telekomunikimi, softuer, tregti dhe shërbime BLIZU MEDIA END BROUDBEND Shkup, për qytetetet Shkup, Tetovë, Shtip, Prilep, vërtetim nr. 46 me çka paketa e regjistruar programore si e tërë plotësohet me servisin programor televiziv DM SAT.

Vazhdimësi nga seanca nr. 36-të e mbajtur më datë 23.07.2013

-Këshilli i Radiodifuzionit (KRD) në seancën e sotme solli vendim për ndërprerjen e inicimit të procedurës për marrjen e lejes për ushtrim të veprimtarisë radiodifuzive të shoqërisë tregtare radiodifuzive Energy Radio – Strugë, për shkak se transmetuesi e ka bërë pagesën e kompensimit.